

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Një në katër të punësuar merr pagë minimale/ Rritet pesha e pagave më të larta
ADRESA	https://www.cna.al/ekonomi/nje-ne-kater-te-punesuar-merr-page-minimale-rritet-pesha-e-pagave-me-te-i474224
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 12:22:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:09:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6da24d8b358315cb98cb0dc49b9a288bd50dc86182006d219f70623af8b678e2
TEKSTI	f0f10cf4fbed858baa607edd0e568f8d6ed7251290d8d8f06fdcf55396a7ff98
PAMJA	01eca2ff9f08ab645172475d8c64921128a91d18f46021d96208115b431f1e3d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7e504382ef974a7229539319f46a8238b3f855257c0e3b188a9eabb6909d2c71
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5f8ef0f8d1c556c1a23c45b5f0b4a2927fefdb161a9dff8be1ca6faf0b0d4224
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7e504382ef974a7229539319f46a8238b3f855257c0e3b188a9eabb6909d2c71>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

14:14 Aktualitet

Censi i Bujqësisë dhe Blegtorisë nuk do të zhvillohet gjat...

Një në katër të punësuar merr pagë minimale/ Rritet pesha e pagave më të larta



15 Shtator 2026, 14:09, Ekonomi CNA



Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontribute rezultojnë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, ndërsa po rritet ndjeshëm pesha e punonjësve në fashat më të larta të pagave, sipas të dhënave zyrtare mbi ecurinë e pagave në tremujorin e dytë të vitit 2026.

Ndryshimi i strukturës së pagave lidhet me rritjen e pagës minimale nga 40 mijë në 50 mijë lekë në fillim të këtij viti, por edhe me rritjet e pagave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, mungesën e fuqisë punëtore dhe konkurrencën më të fortë të bizneseve për të tërhequr ose mbajtur punonjësit.

Në fund të vitit 2025, përpara rritjes së pagës minimale, rreth një e treta e të punësuarve mermin deri në 50 mijë lekë. Koncretisht, 12.8% paguheshin deri në pagën minimale prej 40 mijë lekësh, ndërsa 21% mermin nga 40,001 deri në 50 mijë lekë. Në total, këto dy kategori përbënin 33.8% të të punësuarve.

Brenda gjashtë muajve, pesha e punonjësve me paga deri në 50 mijë lekë është reduktuar me rreth 8 pikë përqindje. Një pjesë e këtij ndryshimi erdhi nga rritja e pagës minimale, e cila zhvendosur në fashën e re prej 50 mijë lekësh punonjësit që më parë deklaroheshin me paga më të ulëta.

Paralelisht është zgjeruar edhe pesha e punonjësve me paga dukshëm më të larta, duke sinjalizuar një zhvendosje graduale të strukturës së pagave drejt niveleve më të larta.

Gati gjysma e të punësuarve kontribuues, ose 48.3%, mermin mbi 75 mijë lekë në muaj në tremujorin e dytë 2026. Në fund të vitit 2025 kjo kategori përbënte 43% të totalit.

Rritja është e dukshme edhe te pagat mbi 95 mijë lekë. Në tremujorin e dytë, 32.1% e të punësuarve mermin mbi këtë nivel, nga 29.4% në tremujorin e katërt 2025.


Veçanërisht është shtuar pesha e të punësuarve me paga mbi 120 mijë lekë. Ata përbënin 17.1% të totalit në tremujorin e dytë 2026, nga 14.1% në të njëjtën periudhë të vitit 2025.

Në rritjen e peshës së pagave më të larta mund të kenë ndikuar disa faktorë. Mungesa e fuqisë punëtore, e lidhur edhe me emigracionin dhe tkurrjen e popullsisë në moshë pune, i ka detyruar bizneset në shumë sektorë të ofrojnë paga më të larta për të gjetur dhe mbajtur staf.

Një tjetër faktor është rritja e pagave në sektorin publik dhe efekti që ajo ushtron mbi sektorin privat, sidomos për profesionet ku shteti dhe bizneset konkurrojnë për të njëjtën kategori punonjësish.

Po ashtu, rritja e kostos së jetesës gjatë viteve të fundit ka shtuar presionin e punonjësve për paga më të larta, ndërsa kompanitë me mungesa personeli janë detyruar të bëjnë korrigjime më të shpejta të pagave.

Struktura e punësimit po ndryshon, me një peshë më të madhe të profesioneve të kualifikuara dhe sektorëve që paguajnë mbi mesataren, ndërsa aktivitetet me paga të ulëta përballen me mungesën e punonjësve. /Monitor





Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Kursi i këmbimit, 15 shtator 2026

Nafta në Shqipëri kushton 2.6 herë më shumë se mesatarja e gjithë Europës

Euro e nis edhe këtë javë në rënie, prek vlerën e 91.8 lekëve

Shqipëria mbetet pa masa fiskale për naftën/ Akti Normativ i akcizës nuk është më në fuqi

Ndryshime për monedhat e huaja/ Kursi i këmbimit valutor, 14 shtator

Taksat e Ramës mbysin çmimin e naftës/ Shqipëria, më e shtrenjta në rajon

Shqipëria, me kostot më të larta të prodhimit bujqësor në rajon

Pse i kemi çmimet kaq të shtrenjta? / TVSH e ushqimeve, ndër më të lartat në Europë

Kursi i këmbimit, 13 shtator 2026

Nafta kap rekorde të reja, arrin 229 lekë, benzina 219 lekë për litër/ A rrezikohet furnizimi?!

Shqipëria: Bonusi erdhi, lindjet u tkurrën

Monedhat e huaja thellojnë rënien/ Kursi i këmbimit, 12 shtator 2026

Euro prek minimum të ri, thyen për herë të parë edhe pragun e 92 lekëve

Turizmi dhe remitancat e ulën deficitin e bilancit të pagesave në nivelin më të ulët prej vitit 2018

Dy reparte ushtarake marrin 271 milionë euro investime këtë vit, 37% të buxhetit të mbrojtjes

Të rinjtë ikin, por edhe ata që mbeten nuk kanë ku punojnë, papunësia e tyre rritet 16%

Euro, paundi dhe dollari në rënie/ Kursi i këmbimit, 11 shtator 2026

BQE rrit normat e interesit në 2.5%, për herë të dytë këtë vit

Dërgesat e emigrantëve arrijnë rekord të ri historik prej 621 milionë eurosh në janar - qershor


Drafti për objektet e konfiskuara në Kuvend, fondi për punimet dhe blerësit arrin 3.5 mln euro

[editorial](#)

13:52 Editorial Elvi FUNDO

Erion Veliaj nuk i lë prokurorisë asnjë mundësi për ta harruar

CNA LIVESTREAM





[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.